



Më të rëndësishmet shkurtimisht

Kontributet e tarifës ekzekutuese

KKP donë të nxisë trajnimin e mëtejme të punëmarrësve në degën e pastrimit dhe të përmirësojë kushtet e punës dhe të pagave. Ofertat trajnuese dhe kontrollet e ndërmarrjeve financohen përmes kontributeve të tarifës ekzekutuese. Ato përbëjnë 0,45 përqind të pagës për punëmarrësit dhe 0,2 përqind të shumës së pagës për punëdhënësit. Nxënësit e zanatit paguajnë 1 frang në muaj. Si anëtar i Unia ty të kthehet pjesa jote.

Ne ti kthejmë ty kontributet e tarifës ekzekutuese. Drejtohu në sekretariatit tënd të Unia!

Trajnim të mëtejme për më shumë pagë

Partnerët e Kontratës të degës së pastrimit organizojnë një arsimim 80 orësh pa pagesë për punonjës pastrimi të pakualifikuar. Pas përfundimit të kursit të KKP ti kalon në shkallë më të lartë page (pastrim mirëmbajtjeje II, pastrim special II, pastrim makinash II) dhe në përputhje fiton më shumë.

Pasi që në botën e punës është me rëndësi, te flitet mirë gjermanishtja, partnerët kontraktues organizojnë gjithashtu kurse të gjermanishtes për të punësuarit në degën e pastrimit. Për anëtarët e Unia ato janë falas.

Lajmërohu tek sekretariati i Unia në afërsinë tënde, nëse ti ke nevojë për më shumë informacione, apo nëse donë të lajmërohesh për një kurs!

Regjistrimi i kohës së punës

Mjerisht në degën e pastrimit ndodh që punëdhënësit nuk e regjistrojnë dhe përlogarisin drejt kohën e punës. Juridikisht është e qartë: Gjithçka, që kryhet si punë, duhet edhe të paguhet! Andaj, ndërmarrja jote është e obliguar që të regjistrojë me shkrim të dhënat vijuese:

- Vendi ose objekti i punës
- Fillimi dhe mbarimi i kohës së punës (varësisht nga rasti edhe koha e udhëtimit)
- Pauzat pa pagesë

Ti ke të drejtë në çdo kohë, të kontrollosh kohën e regjistruar të punës. Nënshkruaji ato, vetëm nëse janë korrekte. Regjistro përditë kohën tënde të punës edhe vet ti.

Nëse ndërmarrja gabon apo nuk e regjistron kohën e punës, drejtohu në Unia.


Kush është Unia?

Unia, me rreth 180 000 anëtarë është sindikata më e madhe në Zvicër dhe ajo angazhohet për interesat e punëmarrësve. Ajo përmbyllë Kontrata Kolektive të Punës dhe përmes tyre përmirëson pagat, kushtet e punës dhe përfitimet shoqërore në degë e sektorë të ndryshëm.

Ne u ofrojmë anëtarëve tanë një sërë shërbimesh: Ne ndihmojmë tek problemet në vendin e punës. Shërbimi ynë juridik mbështetë anëtarët në rast konflikti me punëdhënësin dhe sigurimet shoqërore, nëse lyp puna edhe para gjyqit. Unia merr pjesë edhe në trajnimet e mëtejme dhe ofron një sërë lirimesh, ndër të tjera për pushime, Reka-çeqe dhe sigurim të mbrojtjes juridike.

Unia është aktive në të gjitha regjionet e Zvicrës. Bashkëpunëtorët tanë të këshillojnë me kënaqësi në gjuhë të ndryshme.

**Lufto bashkë me ne për kushte më të mira pune!
Anëtarësohu tani në Unia!**



Së bashku jemi më të fortë!

**Dëshiron më shumë informacione mbi KKP të degës së pastrimit në Zvicrën gjermane?
Apo përndryshe ke një pyetje tjetër?**

Më shumë informacione gjen në ueb faqen:
www.unia.ch/reinigung



Ose drejtohu në sekretariatit e Unia në afërsi tënde.

UNIA



Kontrata Kolektive e Punës në degën e pastrimit 2022–2025

Kushte më të mira pune për punonjësit e Zvicrës gjermane

UNIA

Kontrata Kolektive e Punës 2022–2025

Kjo është e re

Më të rëndësishmet shkurtimisht

Kontrata Kolektive e Punës (KKP) në degën e pastrimit do të negociohet mes punëdhënësve dhe sindikatave dhe vlen për të punësuarit e pastrimit në Zvicrën gjermane. KKP janë shumë të rëndësishme për të punësuarit: Pagat minimale, pushimet, orari i punës dhe shumëçka tjetër janë të përcaktuara në te. Kushtet e punës janë më të mira, sesa nëse punëmarrësit do të negocionin vet.

Tashmë kemi arritur shumë. Ne vazhdojmë të luftojmë!

Që nga futja e KKP në vitin 2004 pagat minimale në pastrim janë rritur për 35 përqind. Unia angazhohet që ky zhvillim të vijojë më tej. Puna jote është e vështirë dhe jashtëzakonisht e rëndësishme për shoqërinë në tërësi. Pastërtia ka çmimin e saj! Ti meriton pagë më të lartë dhe respekt për punën tënde.

Ka nevojë edhe për ty! Sa më shumë anëtarë që ka Unia, aq më shumë arrijmë ne bisedimet për paga dhe KKP.

Paga minimale më të larta	nga 2023	nga 2024
Pastrim mirëmbajtjeje I	CHF/h 20.20	20.80
Pastrim mirëmbajtjeje II	CHF/h 21.20	21.80
Pastrim special I	CHF/h 22.30	22.70
Pastrim special II	CHF/h 23.30	23.70
Pastrim spitali I	CHF/h 20.80	21.20
Pastrim spitali II	CHF/h 21.80	22.20
Pastrim makinash I	CHF/h 22.10	22.50
Pastrim makinash II	CHF/h 23.10	23.50
Pagë minimale me EBA	CHF/h 22.00	22.00
Pagë minimale me EFZ	CHF/h 24.75	24.75

Pagat minimale në pastrim janë rritur. Këto paga duhet të paguhet në tërë Zvicrën gjermane. Rishtas puna në shtëpitë e kujdesit bie në kategorinë e pastrimit të spitaleve; kjo fuqi pastruese ka të drejtë për më shumë pagë.

Më shumë kontrolle

Në pastrim dumpingu në paga është i përhapur edhe më tej. Unia është angazhuar që të ketë më shumë kontrolle kontratash. Pos kësaj tani e tutje nuk lejohet që pagat të paguhet me para në dorë.

A nuk respektohen rregullat e KKP në rastin tënd? Merr gjithsesi kontakt me Unia – ne të ndihmojmë në realizimin e të drejtës tënde.

Për kënd vlen KKP?

- Për të gjithë punonjësit deri dhe përfshirë nivelin e kryepunëtorit dhe udhëheqës:e objekti në të gjitha ndërmarrjet, të cilat kryejnë punë pastrimi dhe kanë më shumë se pesë të punësuar.
- Për ndërmarrjet me më pak se pesë të punësuar, vlejnë vetëm disa nga rregullat e KKP, si pagat, ditët festive, vazhdimi i marrjes së pagës tek sëmurja dhe lehonja. Nëse ke pyetje drejtohu në sekretariatit e Unia të regjionit tënd.
- KKP vlen edhe për punonjësit me kohë të pjesshme.
- KKP nuk vlen për të rinjtë që ndihmojnë me punë gjatë pushimeve.

13. Paga minimale

Të gjithë të punësuarit marrin pagën e 13-të.

Koha e punës

Koha normale javore punës është më së shumti 42 orë. Orët e tepërta duhet të paguhet ose kompensohen deri më 30 prill të vitit vijues.

Pushimet

- 5 javë (25 ditë pune) deri dhe me moshën 20 vjeç
- 4 javë (20 ditë pune) nga mosha 21 vjeç
- 5 javë (25 ditë pune) nga mosha 50 vjeç (tek së paku 5 vite shërbimi)

Ditë feste

Ditë feste të paguara janë 1 gushti si dhe tetë ditë feste kantonale.

Pushimi i lehonisë

Pas lindjes pushimi i lehonisë është 16 javë. Nën gjatë kësaj kohe marrin një zëvendësim të pagës. Kjo përbënë 80 përqind të pagës të paguar së fundi, gjegjësisht të pagës mesatare të gjashtë muajve të fundit. Kush nuk ka të drejtë në zëvendësim të pagës në rast lehonie, megjithatë falë rregullit të KKP merr për tetë javë 80 përqind të pagës.

Paga në rast sëmundjeje

A punon ti së paku 12,5 orë në javë? Atëherë ti je i/e siguruar për humbe të pagës në rast sëmundjeje. Mëditjet në rast sëmundjeje përbëjnë 80 përqind të pagës të paguar së fundi, gjegjësisht të pagës mesatare të gjashtë muajve të fundit. Ti në rast sëmundjeje merr parat e mëditjeve nga dita e tretë deri më së shumti 730 ditë.

A punon ti së paku 12,5 orë në javë? Në rast sëmundjeje në vitin e parë të punësimit ti merr pagën tënde përgjatë tri javëve. Me rritjen e viteve të shërbimit vazhdon zgjatja e vijimit të pagesës së pagës. Kohëzgjatja është e rregulluar varësisht nga kantoni

Ti nuk e ke të qartë, sa pagë merr ti në rast sëmundjeje dhe sa gjatë? Unia e regjionit tënd të këshillon me kënaqësi!

Koha e udhëtimit

Koha, të cilën e kalon ti në mision për punëdhënësin tënd, llogaritet si kohë pune. Nëse ti me detyrë të ndërmarrjes nga vendi yt normal i punës ose vendndodhjes së ndërmarrjes udhëton tek myshterinjtë, kjo duhet të paguhet (koha e punës dhe kostoja e udhëtimit). Udhëtimi nga vendbanimi yt tek vendi i zakonshëm i punës nuk vlen si kohë e paguar e udhëtimit.

Ngrëna e drekës

A punon ti së paku gjashtë orë në ditë dhe duhet të hash drekën tënde jashtë vendit të zakonshëm të punës? Atëherë ndërmarrja jote duhet të ti paguajë 16 franga shpenzime në ditë.

Veshmbathja profesionale

Ndërmarrja ti venë në dispozicion rrobat e punës. Larja dhe arnimi janë çështje të punëmarrësit.

Dhurata e viteve të shërbimit

Punonjësit nga viti i dhjetë në shërbim në çdo pesë vjet për vitet e shërbimit marrin si dhuratë: çerekun e pagës mujore.